



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr.173, datë 21.12.2020

### **PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” I FINANCUAR ME FONDET E BUXHETIT TË SHTETIT, PËR VITIN 2020 NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”; vendimit nr. 09, datë 05.02.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin dhe zbatimin e programit social të strehimit ”Subvencionimi i interesave të Kredisë”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit”; vendimit nr.84, datë 27.07.2020 të këshillit bashkiak “Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit për fazën dytë të programit social të strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë” i financuar me fondet e buxhetit të shtetit”, si dhe në vijim të Raportit Përmbledhës me nr. 43985 prot., datë 14.12. 2020 të Komisionit të Strehimit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2020, sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Individët/familjet e përcaktuara në aneksin nr. 2, humbasin të drejtën për të përfutuar nga ky program strehimi, nëse brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi nuk depozitojnë plotësimin e dokumentacionin sipas përshkrimit të bërë për secilin aplikues. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale koordinon punën me Njësitë Administrative/lagjet përkatëse me qëllim njoftimin e individëve/familjeve për dokumentacionit që duhet të dorëzojnë.
3. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 2, duhet të dorëzohet pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët dhe duhet të jetë lëshuar nga institucionet përgjegjëse, sipas formës së kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore, jo më vonë se 3 muaj nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale jo më vonë se 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, përcjell dokumentacionin e plotësuar pranë komisionit të strehimit, i cili verifikon nëse dokumentacioni i depozituar është në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë vendim dhe anekset bashkëlidhur tij. Për aplikuesit që kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar, komisioni harton listën e përfituesve duke specifikuar strukturën e apartamentit dhe nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë informon Këshillin Bashkiak. Lista e përfituesve sipas kësaj pike shpallet në stendat e Bashkisë Tiranë dhe faqen zyrtare të saj.

5. Individët/familjet përfituese, të paraqiten pranë institucionit bankar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga momenti i njoftimit të këtij vendimi.
6. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5, në rastet kur individët/ familjet nuk gjejnë banesë brenda 6 muajve nga momenti i njoftimit, të paraqiten pranë institucionit financiar, si edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Entit Kombëtar të Banesave, përpara përfundimit të afatit të lartpërmendur, duke kërkuar shtyrjen e tij edhe me 6 muaj të tjerë. Mosrespektimi i këtij afati përbën shkak për skualifikimin e tyre.
7. Individët/familjet nëse shpallen përfitues sipas këtij vendimi janë edhe aplikuesit të cilët rezultojnë të kenë dorëzuar dokumentacionin nga data 18.07.2020 deri më 10.08.2020 pranë Bashkisë Tiranë.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale pas ezaurimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim të dërgojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Entit Kombëtar të Banesave si edhe institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshje, listat e përfituesve.
9. Individët/familjet që nuk janë shpallur përfitues nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, kanë të drejtën e ankimit administrativ, pranë kryetarit të Bashkisë ose personit të autorizuar prej tij, brenda 5 ditëve pune nga momenti i shpalljes publike të listës së përfituesve. Ankimi dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimit Social, e cila së bashku me dosjen e ankuesit ia paraqet kryetarit të Bashkisë, apo personit të autorizuar prej tij, i cili brenda 5 ditëve pune del me vendim në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesit.
10. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**ROMINA KUKO**